

# Informacion Kryesor Për Investitorin

Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi Fondin Raiffeisen Prestigj. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me Ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe risqet që shoqërojnë investimin në fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo në këtë fond.

## FONDI I INVESTIMIT RAIFFEISEN PRESTIGJ

është sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike dhe me pjesëmarrje të hapur, që administrohet nga Raiffeisen Invest – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

Kuotat e Fondit nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në fondin Raiffeisen Prestigj nuk është një investim i garantuar, fondi nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të asetëve, dhe risku i humbjes së principalit përballohet nga investitori.

### Objektivat dhe Politika e investimit\*

Objekti i Fondit është që të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm. Asetet e Fondit investohen kryesisht në tituj borxhi të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në monedhën Lekë.

Fondi investon deri në 100% të asetëve të tij në tituj borxhi qeveritar, të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë; deri në 5% në fonde investimi me fokus në tituj borxhi; deri në 50% në ekuivalentë cash-i, transaksione të anasjellta të riblerjes dhe depozita bankare me maturitet deri në 12 muaj.

Fondi mund të investojë deri në 5% të asetëve edhe në instrumente borxhi të emetuara nga organet e qeverisjes vendore dhe shoqëri tregtare vendase, të tregtuara në tregje të rregulluara ose bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë.

Fondi përcakton natyrën e investimeve të asetëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Fondi menaxhohet pa ju referuar një standardi të ardhurat e fondit nuk shpërndahen por ri-investohen.

Monedha baze e Fondit është Lekë. Investimet dhe shlyerjet bëhen në Lekë.

Shitja e kuotave të fondit mund të bëhet në çdo kohë nga ana e investitorit me kërkesë të tij, shlyerja e tyre bëhet brenda afatit ligjor prej 7 ditësh nga dita e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitje.

Performanca e Fondit dhe rrjedhimisht edhe vlera e investimit mund të luhet në varësi të kushteve të tregut. Luhetja e normave të interesit të instrumenteve financiare në të cilat fondi investon është faktori kryesor i cili ndikon në performancën e fondit.

Kostot e transaksioneve të portofolit nuk kanë një ndikim material mbi performancën e fondit.

**Rekomandim:** Fondi Raiffeisen Prestigj mund të mos jetë i përshtatshëm për investitorë që planifikojnë të shlyejnë kuotat e tyre brenda 1 viti.

Fondi nuk duhet të përdoret si një llogari rrjedhëse, por si një mënyrë investimi afatshkurtër dhe afatmesme me qëllim sigurimin e një kthimi të kënaqshëm dhe diversifikimin e asetëve. Qëndrimi shumë i shkurtër në fond mund të rezultojë në një kthim të pakënaqshëm.

\*Për më tepër informacion mbi objektivat e investimit jeni të lutur ti referoheni prospektit të Fondit Raiffeisen Prestigj.

### Profili i Risk dhe Përfitimit

#### Risk i ulët

Potencial Përfitimi më i ulët

#### Risk i lartë

Potencial Përfitimi më i lartë

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

- Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit ka për qëllim ti japë investitorit një ide mbi luhetshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës. Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhetshmërisë.
- Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.
- Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës.
- Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.
- Bazuar në të dhënat historike të kthimeve të fondit gjatë 5 viteve të fundit, profili i parashikuar i riskut të fondit i përket kategorisë 2 të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit (SRRI=2).

#### Risqe me rëndësi materiale të cilat nuk mbulojnë tërësisht nga treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit:

**Risku i kreditit:** ky risk lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e asetëve të Fondit, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, cka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e asetëve të Fondit.

**Risku i likuiditetit:** risku që një aset të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafërt me vlerën e tregut. Tregu sekondar i bonove dhe obligacioneve të qeverisë shqiptare konsiderohet një treg me aktivitet të kufizuar.

**Risk i palës tjetër:** risku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonë. Gjithashtu ky risk lidhet me mundësinë që pala tjetër të mos jete në gjendje të realizojë pagesat sipas kushteve të një marrëveshjeje apo transaksioni të paracaktuar.


**Risku operacional:** risku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabimet njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e marketingut, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

## Komisionet dhe tarifat

Komisionet dhe tarifat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit Raiffeisen Prestigj, duke përfshirë këtu kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të fondit. Këto komisione dhe tarifa zvogëlojnë rritjen potenciale të investimit.

<b>Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit</b>	
Komisioni/tarifa e hyrjes	<b>0.00%</b>
Komisioni/tarifa e largimit	<b>0.00%</b>
<b>Komisione/tarifa të vazhdueshme që mbahen gjatë 1 viti</b>	<b>1.25%</b>
<p>Shifra e tarifës së vazhdueshme mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2021. Tarifa e vazhdueshme përfshin tarifën e administrimit dhe çdo tarifë të vendosur gjatë vitit të kaluar. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifat e vazhdueshme që paguhen nga asetet e fondit në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë 1.40% në vit të vlerës neto të asetëve të fondit. Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.</p> <p>Lutemi referojuni zërit "Shpenzime" të raportit vjetor të fondit për detaje të mëtejshme lidhur me komponentët e tarifës së vazhdueshme. Për më tepër informacion rreth kostove/tarifave, jeni të lutur ti referoheni seksionit 2.15 të prospektit të Fondit të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese : <a href="http://www.raiffeisen-invest.al">www.raiffeisen-invest.al</a>;</p>	
<b>Komisione/tarifa të veçanta</b>	
Komisioni/tarifa e Performancës	<b>E paaplikueshme</b>

## ■ Paraqitja e performancës së shkuar



Performanca e shkuar shërben vetëm për qëllime informative dhe nuk përfaqëson premtim apo garanci për performancën e fondit në të ardhmen. Performanca e treguar në grafik është kthimi neto i fondit, pasi janë zbritur tarifat e vazhdueshme. Fondi ka filluar veprimtarinë e tij në 1 Shkurt 2012. Performanca e kaluar është e llogaritur në monedhën Lekë.

## ■ Informacione Praktike

- Banka Depozitare është Banka e Parë e Investimeve sh.a.
- Kopje të prospektit dhe raporteve më të fundit të ecurisë së Fondit mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al), si dhe pranë degëve të Raiffeisen Bank sh.a.
- Cmimi i kuotës së fondit publikohet çdo ditë në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al), ku mund të gjeni informacion më të detajuar mbi fondin.
- Regjimi tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë aplikohet mbi të ardhurat e realizuara, të cilat rezultojnë nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në fond.
- Raiffeisen INVEST sh.a. është përgjegjëse e vetme për çdo informacion/deklaratë të përfshirë në këtë dokument që është çorientues, i pasaktë ose në kundërshtim me pjesët përkatëse të prospektit të fondit.

Ky fond është i licencuar dhe rregullohet në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Raiffeisen INVEST sh.a është e licencuar dhe rregullohet në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit 22 Shkurt 2022.